



VENDIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

Data e miratimit: 11 dhjetor 2020

Nr. i lëndës: 2016-17

Milijana Avramović

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 dhjetor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald HOOGHIEMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Përmes letrës së datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar Misionin se kjo lëndë ishte e regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar ankueses që të sigurojë informata shtesë në lidhje me ankesat e saj. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli ka dërguar dy kërkesa të tjera për informacion shtesë. Paneli nuk mori asnjë përgjigje në lidhje me këtë lëndë.
4. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i ka përcjellë deklaratën e fakteve dhe pyetjeve shfesë së Misionit (ShM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë të paraqiste përgjigjet dhe vërejtjet e saja me shkrim për ankesat deri me datën 26 janar 2018.
5. Përmes letrës së datës 17 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar që përsëri të ofronte përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019. Përmes letrës së datës 8 prill 2019, Paneli

përsëri i kërkoi ShM-së që të sigurojë përgjigje për pyetjet sa më shpejt që është e mundur. Me datën 20 qershor 2019, ankuesja ishte informuar që Paneli ishte ende në proces të shqyrtimit të ankesës së saj. Vërejtjet e ShM-së përfundimisht ishin marrë me datën 30 korrik 2019, pas së cilës ato iu komunikuan ankuesve për vërejtje shtesë.

6. Më 5 gusht 2019, komentet e ushtruesit të detyrës së ShM-së iu dërguan ankueses, dhe asaj iu kërkua të paraqiste komentet e veta, nëse kishte ndonjë, jo më vonë se me datën 6 shtator 2019. Ajo nuk e shqyrtoj atë mundësi.
7. Më 11 dhjetor 2019, Paneli gjeti se lënda ishte e pranueshme (<https://hrrp.eu/alb/docs/Decisions/2019-12-11%20Admissibility%20Decision%202016-17-a.pdf>) në lidhje me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa Evropiane").
8. Më 4 qershor 2020, Paneli lëshoi Vendimin dhe Gjetjet e tij në lidhje me meritën e lëndës (<https://hrrp.eu/docs/decisions/2020-06-04%20Decision%20and%20Findings%202016-17%20signed.pdf>). Në atë Vendim, Paneli gjeti që Misioni kishte shkelur të drejtat themelore të ankuesit sipas neneve 2 (pjesët procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të marrë parasysh rekomandimet e mëposhtme:
 - i. Të pranoj shkeljen e të drejtave të ankueses nga ana e Misionit;
 - ii. Të ofroj një kopje të këtij vendimi tek
 - a) organet përkatëse të Misionit,
 - b) autoritetet përkatëse politike në Bruksel dhe, tek
 - c) autoritetet vendore kompetente për të hetuar këtë rast;
 - iii. Të urdhëroj që kjo lëndë të monitorohet nga organet kompetente të Misionit;
 - iv. Të pyeten autoritetet vendore kompetente se çfarë hapash, nëse ka pasur, janë ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe cilat hapa të ardhshëm janë duke u planifikuar;
 - v. Të kontaktohet ankuesja me qëllim të gjetjes së një mënyre për të korigjuar shkeljen e të drejtave të saja.
9. Me një letër të datës 30 tetor 2020, shefi i Misionit informoi Panelin për masat e marra në përgjigje të rekomandimeve të Panelit.
10. Në përputhje me Rregulloren 45 e *tutje* të Rregullores së tij të Procedurës, Paneli do të kthehet të shqyrtojë parashtrimet e ShM-së në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Panelit.

II. PËRMBLEDHJA E FAKTEVE PËRKATËSE

11. Faktet, siç paraqiten nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë.
12. Më 19 qershor 1999, rreth orës 07.30, bashkëshorti i ankueses, Milorad Avramović, ishte rrëmbyer me katër burra të tjerë dhe një grua në rrugën Shën Starca Vujadina 3/1, Tamnic, në Mitrovicë. Në kohën e rrëmbimit të tij, ai ishte duke e ndihmuar me kamion granan e lartpërmendur për të ndërruar shtëpinë nga jugu i Mitrovicës në veri të Mitrovicës. Ai nuk është parë më kurrë dhe vendndodhja e tij mbetet e panjohur.

13. Kjo lëndë ishte nën përgjegjësinë dhe kompetencën e EULEX-it Kosovë gjatë gjithë periudhës përkatëse, edhe pse Misioni nuk arriti të hetonte hetojë atë dhe nuk arriti t'iu sigurojë ndonjë informacion të afërmeve të personit të zhdukur.

III. PASUESE SIPAS RREGULLIT 45 E TUTJE

14. Rekomandimi i parë i Panelit ishte që shefi i Misionit të pranonte shkeljen e të drejtave të ankesës nga Misioni. Shefi i Misionit nuk arriti ta adresojë këtë rekomandim. Prandaj, Paneli do të ripërsërit kërkesën e vet që ai duhet të konsiderojë ta bëjë këtë. Është theksuar në shumë herë nga Paneli që një masë e tillë do të ishte më e rëndësishme për viktimat dhe një mënyrë që Misioni të 'korrigjoj' dështimin e tij serioz në përputhje me detyrimet e tij themelore të të drejtave të njeriut në këtë rast.

15. Rekomandimi i dytë i Panelit ishte për si në vijim:

Të ofroj një kopje të këtij vendimi tek

- a) organet përkatëse të Misionit,
 - b) autoritetet përkatëse politike në Bruksel dhe, tek
 - c) autoritetet vendore kompetente për të hetuar këtë rast;
16. Shefi i Misionit informoi Panelin se Vendimi i tij ishte "shpërndarë menjëherë" në të gjitha njësitë përkatëse në Mision menjëherë pasi ishte komunikuar në Zyrën Ligjore dhe të Drejtave të Njeriut më 2 korrik 2020". Ai shtoi: 'Gjatë muajve të kaluar, Vendimi po ashtu iu komunikua autoriteteve vendore kompetente për të hetuar këtë rast dhe më specifikisht Policisë së Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit Special të Republikës së Kosovës (PSRK)'.
17. Shefi i Misionit gjithashtu tregoi se "autoritetet përkatëse politike në Bruksel janë informuar në mënyrë rutinore për të gjitha vendimet dhe gjetjet e Panelit dhe ata gjithashtu marrin Raportin Vjetor të Panelit". Paneli kërkon sqarim se cilat autoritete morën kopjen e Vendimit në këtë rast. Sipas këndvështrimit të Panelit, është thelbësore që autoritetet kompetente në Bruksel duhet të jenë plotësisht të njoftuara për shkallën në të cilën Misioni ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut, se cilat gjetje janë bërë në atë drejtim dhe cilat burime ose masa shtesë mund të nevojiten për të adresuar disa nga çështjet në pritje. Prandaj, Paneli do t'i kërkojë shefit të Misionit të sqarojë se cilit autoritet të vendosur në Bruksel u janë dhënë kopjet e Vendimit dhe gjithashtu të ripërsërit kërkesën e tij që t'u transmetohet autoriteteve përkatëse në Bruksel.
18. Rekomandimi i tretë i Panelit ishte që shefi i Misionit të urdhërojë që kjo lëndë të monitorohet nga organet kompetente të Misionit.
19. Në përgjigje, shefi i Misionit dha një përshkrim të gjatë të mandatit aktual monitorues të Misionit. Në përmbledhje, shefi i Misionit tregoi se Misioni do të monitoronte rastin vetëm nëse autoritetet vendore vendosin të hapin dhe hetojnë këtë lëndë. Paneli vëren se kjo lëndë ishte sjellë dhe komunikuar para mandatit aktual të Misionit. Për aq sa kishte ndonjë shqetësim se mandati i ri i parashikuar mund të kishte parandaluar Misionin për të siguruar një zgjidhje të efektshme, duhet të ishin ndërmarrë hapa për të përshpejtuar shqyrtimin dhe përpunimin e lëndës në fjalë.
20. Paneli më tej konsideron se qasja e propozuar është e pakënaqshme dhe nuk ofron ndonjë mjet të duhur për shkeljen e të drejtave themelore të njeriut që i atribuohen Misionit. As nuk pasqyron në asnjë mënyrë peshën e asaj shkeljeje. Paneli nuk mund të interpretojë mandatin aktual të Misionit si dhe të parandalojë atë që të korrigjojë dëmin që ka kontribuar. Bërja e kësaj do ta bënte Misionin të pa përgjegjshëm *pavarësisht nga ekzistenca e Panelit*.

21. Prandaj Paneli fton shefin e Misionit të marrë në konsideratë se cilat hapa mund të ndërmerren, nëse ka, për t'u kujdesur që rastet që përfshijnë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut - të tilla si kjo e tanishmja - që dikur hynë nën përgjegjësinë e Misionit dhe të cilat tani janë ende të pa hetuara t'i nënshtrohen një rishikimi efektiv. Paneli i kërkon Misionit të përshkruajë se si propozon nën mandatin e tij aktual që të mbrohen të drejtat e individëve - siç është ankuesi - të drejtat e të cilëve janë shkelur nga Misioni dhe të cilat vazhdojnë të shkelen.
22. Rekomandimi i katërt i Panelit ishte që Misioni të kërkojë nga autoritetet vendore kompetente se cilat hapa, nëse ka, janë ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe cilat hapa të ardhshëm po planifikohen. Shefi i Misionit nuk e adreson këtë rekomandim. Në vend të kësaj, është paraqitur një përshkrim i përgjithshëm i aktiviteteve monitoruese të Misionit. Prandaj, Paneli ripërsërit ftesën e tij për Misionin që të kërkojë nga autoritetet vendore kompetente se cilat hapa, nëse ka, janë ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe cilat hapa të ardhshëm po planifikohen.
23. Rekomandimi i fundit i Panelit ishte që Misioni të ["kontaktoj ankuesen me qëllim që të gjejë një mënyrë për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të saj". Përderisa shefi i Misionit i shprehu 'keqardhjen e tij më të thellë' ankuseses, nuk ka asnjë tregues se ai ndërmori hapa për të kontaktuar ankuesen. Paneli i kërkon shefit të Misionit të sqarojë nëse është bërë kjo dhe nëse jo pse.
24. Për më tepër, edhe pse i mirëpritur, shprehja e keqardhjes së shefit të Misionit nuk përbën një mjet të mjaftueshëm ose të duhur juridik për shkeljen e rëndë të të drejtave të ankuseses nga ana e Misionit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJEZËRI

GJEN se Misioni ka ndjekur dhe zbatuar disa, por jo të gjitha rekomandimet e Panelit;

GJEN se shefi i Misionit nuk ka arritur të adresojë rekomandimin e Panelit për të pranuar shkeljen e të drejtave të ankesës nga Misioni dhe e **fton** atë të bëjë një pranim të tillë;

SHPREH KRQARDHJE për dështimin e Misionit për ta pranuar shkeljen e të drejtës së ankuseses dhe për të ofruar që të korrigjoj atë;

KËRKON nga shefi i Misionit të sqarojë se cilave autoritete në Bruksel u janë ofruar nga Misioni kopje të Vendimit dhe Gjetjeve të Panelit në këtë rast dhe t'u sigurojë autoriteteve përkatëse në Bruksel vendimin aktual pasues;

E RIPËRSËRIT REKOMANDIMIN E TIJ që Misioni duhet të pyesë autoritetet vendore kompetente se cilat hapa, nëse ka, janë ndërmarrë për të hetuar këtë rast dhe cilat hapa të ardhshëm po planifikohen;

Fton shefin e Misionit për të vlerësuar se cilat hapa ose masa mund të ndërmerren nga Misioni për të korrigjuar dhe mbrojtur të drejtat e atyre - përfshirë ankuesen - të cilat janë shkelur nga Misioni dhe të cilat vazhdojnë të shkelen (me fokus të veçantë në të quajtura 'zhdukje me forcë' ose raste të personave të zhdukur);

KËRKON nga shefi i Misionit të sqarojë nëse, siç rekomandohet, Misioni ka kontaktuar ankuesen për të gjetur një mënyrë për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të saj dhe, nëse jo, pse;

KËRKON nga shefi i Misionit të shpërndajë këtë vendim tek stafit përkatës brenda Misionit dhe autoritetet përkatëse jashtë tij që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së Misionit;

MBETET I ANGAZHUAR në këtë lëndë deri në një njoftim tjetër;

Fton shefin e Misionit të adresojë kërkesat e Panelit deri më datën 28 shkurt 2021.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare

Anna AUTIO
Anëtare

